




RAPORT MONITORIMI

Gusht-Tetor 2021

KRIZË ENER GjITIKE APO KRIZË STRATEGJIKE?

**KRIZË
ENER GjITIKE**

**KRIZË
STRATEGJIKE**



AUTOR

Ergisa Bejkollari

QENDRESA QYTETARE



www.qeverisja.qg.com.al

Përmbajtje

Hyrje	3
Parashikimet për të ardhmen: efektet e ndryshimeve klimaterike, Rasti i Shqipërisë.....	3
Ku dështoi Plani Kombëtar 2019-2020?.....	5
Prodhimi i Energjisë së Rinovueshme: Çfarë u projektua dhe çfarë u realizua	6
(Mos)Konsolidimi i Agjencisë për Burimet e Rinovueshme...	10
Gjetjet kryesore.....	14
Rekomandimet kryesore	14

Hyrje

Nuk është tashmë më një lajm fakti që Shqipëria, në tërësinë e saj është një importuese neto e energjisë elektrike, duke mos patur kështu mundësinë që të plotesojë kërkesat për energji nga konsumatorët vendas, individë, familje ose biznese. Bilanci negativ tregtar reflektohet në çdo hallkë të ekonomisë vendase: që nga çmimet produktit kryesor, pra energjisë elektrike, e deri tek rritja ekonomike. Kjo situatë e nxjerr vendin zbuluar ndaj ngjarjeve të paparashikuara siç është dhe kriza energjitike e javëve të fundit.

Ky kontekst social, ekonomik e natyror, ka sjellë nevojën për t'u paraprirë situatave të vështira të së ardhmes. Organizata e ekspertë vendas shpeshherë i kanë ngritur këto shqetësime duke sugjeruar dhe hapat që mund të ndërmerren nga qeveritë e ndryshme. Duket se zgjidhjet e mundshme të sugjeruara kanë një emërues të përbashkët: diversifikimi i burimeve të energjisë duke shkuar drejt atyre të rinovueshme, jo vetëm hidrike.

Veprimet kritike të ndërmarra nga Shqipëria sot për të mbështetur përdorimin optimal të energjisë, burimeve ujore dhe funksionimin e hidrocentraleve do ta ndihmojnë vendin të menaxhojë më mirë ndryshueshmërinë klimatike dhe të ndërtojë elasticiteti ndaj ndryshimeve klimatike.

Parashikimet për të ardhmen: efektet e ndryshimeve klimaterike, rasti i Shqipërisë

Burimet ujore janë një pasuri kombëtare për Shqipërinë: lumi Drin prodhon rreth 90% të energjisë elektrike të përdorur nga industria vendase dhe familjet shqiptare. Vendi ynë përfaqëson një nga vendet me përqindjen më të lartë të prodhimit të energjisë nga burimet hidrike, por kjo ndërvarësi e lartë nga hidrocentralet sjell sfida: prodhimi i energjisë elektrike mund të variojë nga pothuajse 6,000 Gwh në më pak se gjysma e kësaj sasive në vitet shumë të thata.

Skenarët e ndryshimeve klimatike për Shqipërinë parashikojnë një rritje vjetore të temperaturës deri në 1°C, 1.8°C, 3.6°C përkatësisht deri në vitin

2025, 2050 dhe 2100. Kjo si rrjedhojë do të sjellë një shtim të kërkesës për energji elektrike, sidomos gjatë ditëve të verës.

Nga ana tjetër, skenarët e ndryshimeve klimatike për Shqipërinë parashikojnë një ulje vjetore të reshjeve deri në -3.8%, -6.1%, -12.5% përkatësisht deri në 2025, 2050 dhe 2100¹, sipas tabelës së mëposhtme. Gama e parashikuar e ndryshimeve të reshjeve për të gjitha stinët janë:²

Rënia e nivelit të reshjeve për vitin 2025	Rënia e nivelit të reëshjeve për vitin 2050	Rënia e nivelit të reshjeve për vitin 2100
-3.4 në -2.6%	-6.9 në -5.3%	-16.2 në -8.8%

Tabela 1: Ndryshimet në nivelet e reshjeve për vitet 2025, 2050, 2100

Parashikimet klimaterike projektojnë një rritje të përmbytjeve si rrjedhojë e ngrohjes globale dhe ndryshimeve hidrolgjike. Efekti direkt do të ishte:

Zvogëlimi i prodhimit mesatar vjetor të energjisë elektrike nga hidrocentralet e mëdhenj të Shqipërisë (LHEC) me rreth 15% dhe nga hidrocentralet e vegjël (HEC) me rreth 20% deri në vitin 2050. Pjesa më e madhe e vendit ka parë tashmë ulje të reshjeve.

Prej vitesh tashmë, kërkesa për energji elektrike është përbushur pothuajse tërësisht nga hidrocentralet, me një kapacitet total të instaluar prej 2,011 më në fund të vitit 2016. Sipas të dhënave nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, vendi ka shfrytëzuar afro 50% të potencialit të vet hidroenergjetik dhe zgjerimi i ardhshëm i kapacitetit hidroenergjetik është i mundur kryesisht përgjatë lumenjve Drin, Mat, Devolli dhe Bistrica. Kapacitetet hidrike janë burimet natyrore të rinovueshme më të rëndësishme të energjisë për prodhimin e energjisë elektrike në vendin tonë. Por, ndërvarësia e fortë është faktor i një risku të lartë që do të reflektohet në periudha krizash.

Kërkesa në rritje e konsumit të energjisë për frymë ose nga bizneset, e vendos vendin përballë sfidave të mëdha të brendshme. Këto kombinuar dhe me sfida të mjedisit ndërkombëtar, ngrenë alarmin. Duhet punuar drejt arritjes së eficiencës së energjisë dhe shfrytëzimi sa më parë i burimeve të tjera të rinovueshme që vendi ynë ka.

¹ https://unfccc.int/sites/default/files/sem_albania_sup3.pdf

² <http://ëëë.rec.org/publication.php?id=269>

Dokumentet fillestare me peshën më të madhe sa i përket zhvillimit të mëtejshëm të sektorit energjitik, janë Vendimet nr.480 dhe nr. 580 të Këshillit të Ministrave, përkatësisht Plani i Konsoliduar Kombëtar dhe Strategjia Kombëtare e Energjisë. Megjithatë, pas direktivave të reja të Bashkimit Europian, tashmë qeveria në bashkëpunim me BE, po punon për Planin Kombëtar për Energjinë dhe Klimën është i cili në thelb do të përcaktojë masat për arritjen e objektivit të BRE-së dhe GHG (Green House Gases) në vitin 2030. Plani Kombëtar për Energjinë dhe Klimën, njohur ndryshe si NECP, do vlerësohet nga Sekretariati i Energjisë pas dorëzimit. Dhe më pas, Sekretariati do të monitorojë gjithashtu dhe sa janë realizuar objektivat e vendosura në plan.

Ku dështoi Plani Kombëtar 2019-2020?

Deri në miratimin e VKM-së 580, Politikat e Energjisë së rinovueshme përbëheshin nga dy Planet Kombëtare të Veprimit për BRE-të, (2015–2020) dhe (2018–2020). Ligji parashikon rishikimin e tyre në çdo 2 vjet. Plani i parë, 2015–2020 u rishikua sipas parashikimeve ligjore dhe aktualisht MIE, si përgjegjëse e drejtpërdrejtë për zbatimin, ka në fuqi planin 2018-2020. Ky i fundit, u rishikua në vitin 2019 për të vendosur objektivin kombëtar 38% dhe udhërrëfyesin për arritjen e tij.

Referuar VKM-së nr. 580, Planet Kombëtare të Veprimit deri në 2020-n, përcaktojnë udhërrëfyesin për arritjen e Objektivit Kombëtar: 38% e energjisë që prodhohet në vendin tone do të jete me prejardhje të rinovueshme, jofosile. Përqindja e BRE-ve do të llogaritet në tre¹ sektoret baze:

1. Burimet e Energjisë të Rinovueshme në sektorin e energjisë **elektrike** (BRE-E),
2. Burimet e Energjisë të Rinovueshme në sektorin e **transportit** (BRE-T) dhe,
3. Burimet e Energjisë të Rinovueshme në sektorin e **ngrohje/ftohjes** (BRE-N&F).

Ligji “Për nxitjen e Burimeve të Rinovueshme të Energjisë” u miratua në 2 shkurt 2017. Ky ligj është harmonizuar me ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe reflekton në mënyrë të plotë mundësinë e hyrjes në tregun e liberalizuar të energjisë elektrike të gjeneruesve, nga burime të rinovueshme. Si gjenerues të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme,

janë parashikuar kontratat koncesionare për hidrocentralet e vogla si dhe nxitjen e burimeve të tjera me prejardhje të rinovueshme si Eoliket apo PV.

Në tabelën më poshtë, shihet sesi ka ndryshuar përqindja që është planifikuar të zënë Burimet e Rinovueshme në prodhimin/konsumin e energjisë, sipas të cilës përqindja për vitin 2020 është mjaft ambicioze. Nga ballafaqimi me shirat reale, përdindja prej 38% është gjithashtu e porealizuar.

Pjesa e energjisë së rinovueshme të Shqipërisë në vitin 2009	Mesatarja për 2011-2012	Mesatarja për 2013-2014	Mesatarja për 2015-2016	Mesatarja për 2017-2018	Objektivi për energjinë e rinovueshme në vitin 2020
31.2%	32,6 %	33.2%	34,3 %	35.6%	38%

Tabela 2: Përqindja e konsumit të Energjisë BR ndër vite.

Në këtë raport do trajtohen dy çështjet më të rëndësishme dhe problematike të këtij plani:

- 1- Realizimi i objektivit sipas parashikimit
- 2- Konsolidimi i Agjencisë për Burimet e Rinovueshme

Prodhimi i Energjisë së Rinovueshme: Çfarë u projektua dhe çfarë u realizua

Në vijim, do japim të dhënat faktike në lidhje me kapacitetet shtesë të burimeve të rinovueshme që ishin planifikuar me Planin Kombëtar 2018-2020 si dhe shifrat që vërtet janë realizuar. Për të bërë krahasimin, përdorim raportet vjetore të ERE për vitin 2019 dhe 2020, për shkak të faktit që Plani Kombëtar është publikuar në shtator të vitit 2019 dhe si rrjedhojë nuk e krahasojmë dot me projektimin e vitit 2018.

Teknologjitë shtesë të BRE 2018–2020		2018	Shtesat 2019-2020		Instalimi (MW)
		Fakti (ktoe)	Sasia (ktoe)	Gjenerimi (GWh)	
Zgjerimi me BRE-E	HECV deri në 15 MW	126	18.6	217	57
	Eolike (Wind)	0	47.7	555	150
	Fotovoltaike (PV)	0	68.0	784	490
	MNU	4	17.7	205	41
	Total 1 përfshirë në PKVBRE	130	152.0	1,761	738
BRE-N&F	Biomase drusore Total 2 (ktoe)	0	0		
BRE-T	Biokarburante Total 3 (ktoe)	20.3	20.0		
BRE	Total 1+2+3	150.3	172.0		
Totali	HEC + HECV (në operim 2018)	573.0	634.0	7,369	2,170
	Total BRE	723.0	806.0		
KFBE plan 2020		2070	2,120		
% e BRE në KFBE		35%	38 %		

Tabela 3: BRE-të që duhet të shtohen në konsumin final bruto të energjisë elektrike në periudhën 2019-2020. Burimi: VKM nr.480, dt.31.7.2018

VITI 2019

TË DHËNA TË VITIT 2019 NGA CENTRALET FOTOVOLTAIKE TË LIDHURA NE RRJETIN E SHPERNDARJES (MWh)				
	CENTRAL FOTOVOLTAIK	MW	SUBJEKTI	LIDHJA
PPE	Seman – 2	2	“SEMAN2SUN” sh.p.k	35 kV
PPE	Topojë	1.998	“SONNE” sh.p.k	35 kV
PPE	Topojë 2	1.998	“AED SOLAR” sh.p.k	35 kV
PPE	Topojë (Sheq Marinas)	2	“AGE SUNPOWER” sh.p.k	35 kV
PPE	Topojë (Sheq Marinas) 2	2	“SEMAN SUNPOWER” sh.p.k	35 kV
PPE	Seman Isolar	2	SEMANISOLAR sh.p.k	35 kV
PPE	Plug, Lushnje	2	"AEE"sh.p.k	10 kv

Tabela 4: Impiante fotovoltaike të hyra në prodhim gjatë vitit 2019. Burimi: Raporti vjetor ERE 2019

Në vitin 2019, kanë prodhuar energji elektrike 8 centrale fotovoltaik me fuqi totale të instaluar prej 15 MW. Prodhimi i realizuar nga këto centrale për vitin 2019 arrin në 22,190 MWh, ndërkohë që për vitin 2018 ishte në operim vetëm një central prodhimi të energjisë elektrike nga impiant fotovoltaik, ai i UKKO (Ujësjellës Kanalizimet Korçë) sh.a. me kapacitet të instaluar prej rreth 1 MW, që ka prodhuar energji elektrike nga impianti në fjalë për nevojat e tij të furnizimit.

Hec-e të Lidhur në rrjetin e Transmetimit				JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	DHJETOR	2019
Hec Lashkiza 1	4.076	HEC Lashkiza shpk	110 kV	-	-	-	151	505	232	37	(6)	8	23	292	900	2,141
Hec Lashkiza 2	0.882		110 kV													
Hec Seta 1+2	7.454	"Hydro Seta" sh.p.k	110 kV													14,667
Hec Seta 3	2.722		110 kV													
Hec Seta 4	4.724		110 kV	-			132	2,394	2,228	79	(16)	48	122	3,808	5,873	
HEC Darsi 1	2.24	"Henz Energy" shpk	110 kV													16,116
HEC Darsi 2	7.663		110 kV	0	0	0	0	2,815	2,251	227	43	406	759	4,643	4,974	
HEC Darsi 3	1.066		110 kV													
HEC Slabinje 2C/341	3.400	"Power Elektrik Slabinje" shpk	110 kV	-	-	-	-	-	-	-	-	0	0	0	5	5
	34.227															32,929

Hec-e të reja të Lidhur në rrjetin e Shpërndarjes				JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	DHJETOR	2019
Hec Razdoli	0.765	Hydro Vizion shpk (I pa licensë)	35kV	-	35	144	317	395	132	34	7	10	28	298	276	1,676
Hec Dragostunje	3.1	"HEC-i Dragostunje" shpk	35kV	560	746	987	1,749	2,873	1,009	-	-	206		1,652	2,433	12,214
Hec Stebleve	3.4	"PURE ENERGY STEBLEVA" shpk	35kV	-	3	93	204	370	112	-	-	-		132	464	1,380
Hec Zerec 1	0.55	"EnRel Hydro" shpk	35kV	-	-	-	846	688	332	98	45	36	27	391	730	3,195
Hec Zerec 2	1.315															
Hec Shëngjon 1	0.651	"EDIANI" sh.p.k.	35kV	-	10	-	96	220	224	43	10	6	6			987
Hec Shëngjon 2	0.356														98	274
Hec Blaç	1.3	"BLAC ENERGY" sh.p.k	35kV	-	-	-	164	167	104	20	13	5	7	182	216	878
Hec Qarrishtë	0.3	"IDI-2005" SHPK	35kV	-	-	-	-	34	111	-	-	-		154	208	507
Hec Vendresh	0.456	"HP VENDRESH ENERGY" SHPK	35kV	-	-	-	-	-	7	-	-	-		16	38	60
HEC "Antena"	1.105	"DERBI-E" shpk	35kV	-	-	-	-	-	217	-	-	27	16	464	434	1,158
HEC "Kamenicë"	0.973	HP Kamenica shpk	10	-	-	-	-	-	-	-	64	44	49	345	530	1,031
HEC "Qytezë"	0.9	Muso hec Qytezë	10	-	-	-	-	-	-	-	4	14	24	148	310	499
Hec Marjan Gura e Ves	0.63	Marituda Shpk	10	-	-	-	-	-	-	62	20	9	4	102	225	421
Hec Skatinë	2.677	Skatina Hec Shpk	10	-	-	-	-	-	-	32	18	12	14	192	560	828
Hec Kaparjel	0.2	ABV Konstruksion	10	-	-	-	-	-	-	-	33	9	9	42	53	147
Hec Letaj	0.54	Asi-Tre											10	129	171	310
Hec Nice	2.133	MP-HEC													145	145
Hec Meshurdhe	1.8	SIMA-Com													795	795
Hec Thanez	1.95	AFRIMI K												828	975	1,803
	25															28,033

Tabela 5: HEC-e që kanë hyrë në prodhim gjatë vitit 2019. Burimi: Raporti vjetor ERE 2019

Prodhimi vjetor neto i energjisë elektrike nga impiantet të cilat kanë hyrë në prodhim gjatë vitit 2019 paraqitet në figuren në vijim. Siç shihet përgjatë vitit 2019 kanë hyrë në prodhim gjithsej 29 HEC-e me një fuqi të instaluar prej 59.3 MW, të cilët kanë prodhuar gjatë vitit 2019 sasinë prej 60.962 MWh.

VITI 2020

PRODHIMI GJATE VITIT 2020 NGA CENTRALET FOTOVOLTAIKE TË LIDHURA NE RRJETIN E SHPERNDARJES (MWh)					
CENTRAL FOTOVOLTAIK		MW	SUBJEKTI	LIDHJA	Progr.2020
PPE	UKKO (pa sistemuarne sistem)	1	"UKKO" sha (Ujsjell.Kanal.Korce)		
PPE	Seman – 2	2	"SEMAN2SUN" sh.p.k	35 kV	4,119
PPE	Topojë	2	"SONNE" sh.p.k	35 kV	4,095
PPE	Topojë 2	2	"AGE SOLAR" sh.p.k	35 kV	4,088
PPE	Topojë (Sheq Marinas)	2	"AGE SUNPOWER" sh.p.k	35 kV	4,100
PPE	Topojë (Sheq Marinas) 2	2	"SEMAN SUNPOWER" sh.p.k	35 kV	4,124
PPE	Seman Isolar	2	"SEMANISOLAR" sh.p.k	35 kV	4,079
PPE	ES 2019 sh,p,k	2	ES 2019 sh,p,k	36 kV	244
PPE	SMART WATT sh,p,k	2	SMART WATT sh,p,k	37 kV	243
PPE	Tren Bilisht	2	"RTS" sh.p.k	35 kV	3,228
PPE	Plug, Lushnje	2	"AEE" sh.p.k	10 kv	3,946
TOTAL MUJOR					32,265
Kapaciteti Instaluar i gjithe prodhuesve		21	MW		

Tabela 6: Impiante fotovoltaike të hyra në prodhim gjatë vitit 2020. Burimi: Raporti vjetor ERE 2020

Nga tabela e mësipërme, vëmë re që gjatë vitit 2020 janë instaluar në rrjet dy impiante të reja fotovoltaike, duke e çuar fuqinë totale të instaluar nga PPE në 21MW.

PRODHUES QË KANË HYRË NË PRODHIM GJATË VITIT 2020 (MWh)																	
Hec-e të Lidhur në rrjetin e Transmetimit																	
	Impianti	MW	SUBJEKTI	LIDHJA	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	DHJETOR	PRODH2020
P.Pav	Hec "Moglice"	184		111 kV	-	-	295	15,367	22,287	14,766	10,913	14,379	35,245	21,654	6,719	18,097	159,722
PPE	HEC Egnatia	5	REMI shpk	110 kV	70	731	1,706	1,242	1,241	472	309	202	119	429	369	329	7,218
PPE	HEC Seka & Zais	15	Seka Hydropower shpk	110 kV	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	30	30
		204															166,970
Hec-e të Lidhur në rrjetin e Shperndarjes																	
	Impianti	MW	SUBJEKTI	LIDHJA	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	DHJETOR	PRODH2020
PPE	HEC OSOJE	1.9	OSOJA HPP shpk	35	126	762	1,426	1,421	545	326	307	327	69	182	203	545	6,239
PPE	Hec Voskopoje	1.9	FAVINA 1 shpk	35	-	312	1,078	730	329	191	230	98	62	134	93	398	3,656
PPE	Hec Nderfushas	1.34	SCD Energji shpk	35	-	68	346	201	93	27	3	-	-	98	25	228	1,090
PPE	Hec Rreshen	0.38	Nikolli Energy shpk	10	112	45	69	48	39	19	13	-	54	76	54	91	619
PPE	Hec Gurra	0.5	Uleza Nderim shpk	6	-	-	-	-	-	162	68	53	37	77	85	85	567
PPE	Hec Vile	1.994	Hydro Power Panariti shpk	35	-	-	-	-	59	106	57	48	33	97	45	280	724
PPE	Hec Dukona	0.800	Dukona shpk	20	-	-	-	-	17	7	4	1	-	10	4	26	68
PPE	Hec Prevali	1.750	Gega-G shpk	35	-	-	-	-	-	-	-	2	16	385	123	476	1,003
PPE	HEC Camerice	0.800	Rei Energy shpk	35	-	-	-	-	-	-	-	-	-	43	14	329	385
PPE	Hec Stror	2.000	Era Hydro shpk	35	-	-	-	-	-	-	-	-	-	350	116	263	729
PPE	Hec Mivas	1.940	Elva 2001 shpk	35	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1	97	98
PPE	Hec Spathare	1.038	Lucente concensionare shpk	10	-	-	-	-	-	-	-	-	-	0	11	25	36
PPE	Hec Miraka	0.600	Kuarci Blace shpk	10	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	17	17
PPE	Hec Shegjun	2.000	Irarba Energji shpk	10	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	101	101
PPE	Hec Dobrunje	0.840	W.T.S. Energji shpk	10	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	27	27
		19.8															15,359

Tabela 7: HEC-e që kanë hyrë në prodhim gjatë vitit 2020. Burimi: Raporti vjetor ERE 2020

Nga shifrat e hijëzuara në tabelën më sipër, shihet që në vitin 2020, kanë hyrë në prodhim 18 HEC-e të reja, me një fuqi shtesë të instaluar 224MW.

Projeksionet

Nga Plani Kombëtar i rishikuar në vitin 2019, shohim që kapacitetet e projektuara që të shtoheshin deri në fund të vitit 2020, janë:

- 57MW nga instalimi i HEC-eve të vogla deri në 15MW.
- 150MW nga energjia eolike, nëpërmjet erës.
- 490MW nga energjia diellore, pra instalimi i impianteve fotovoltaike.
- 41MW nga instalimi i përpunuesve të Mbetjeve të Ngurta Urbane (MNU).

Krahasimi sasior i projeksioneve dhe realizimeve 2019-2020

Teknologjitë shtesë të BRE 2018-2020	Projeksion	Fakti (2019+2020)	% Realizimi
HECV deri në 15 MW	57	283.3	497%
Eolike	150	0	0%
Fotovoltaike	490	21	4.2%
MNU	41	0	0%

Tabela 8: Krahasimi sasior i projeksioneve dhe realizimeve 2019-2020. Burimi: Ergisa Bejkollari, Raport Monitorimi MIE Korrik-Tetor

(Mos)Konsolidimi i Agjencisë për Burimet e Rinovueshme

Një nga detyrat më të rëndësishme që përcaktohet nëpërmjet Planit Kombëtar të Energjisë dhe Strategjisë kombëtare, është ngritja dhe konsolidimi i Agjencisë për Burimet e Rinovueshme (më poshtë referuar ABR).

Qysh në korrik të vitit 2018, kur ish-ministri Gjicknuri prezantonte Strategjinë Kombëtare të Energjisë, parashikohej ngritja e ABR-së si organi monitories i realizimit të objektivave të vendosura. Kjo detyrë i caktohet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila detyrohet të raportojë në lidhje me ecurinë.

“Sipas ligjit për burimet e rinovueshme të energjisë, zbatimi i Planeve Kombëtare të Veprimit për BRE-të do të monitorohet nga agjencia

përgjegjëse për burimet e rinovueshme të energjisë, e cila pritet të ketë autoritet dhe kompetenca në monitorimin e pajtueshmërisë me objektivat e përcaktuar për të gjitha burimet e rinovueshme, përfshirë biokarburantet. Në të njëjtën kohë, ligji i ri për biokarburantet do t'i japë Agjencisë përgjegjëse për burimet e rinovueshme të energjisë, përgjegjësinë për monitorimin dhe verifikimin e përputhshmërisë së prodhuesve të biokarburanteve me kriteret e qëndrueshmërisë të përcaktuara në ligj", thuhet në VKM-në nr. 480.

Agjencia përgjegjëse për Burimet e Energjisë së Rinovueshme luan një rol të rëndësishëm në arritjen e objektivave të përcaktuara në Planin Kombëtar të Energjisë. Si Agjenci përgjegjëse për BRE-te³ dhe si institucion në varësi të ministrit, **duhet të kryente** këto detyra:

- krijimin, regjistrimin dhe përditësimin e regjistrit të prodhuesve nga HECV;
- regjistrimin e bilancit të energjisë të të gjithë prodhuesve me përparësi;
- hartimin dhe dorëzimin në ministri, të draft-PKVBRE, në afatet e përcaktuara nga ligji;
- monitorimin e zbatimit të PKVBRE, të miratuar nga Këshilli i Ministrave;
- hartimin dhe dorëzimin në Ministri dhe ERE, brenda datës 1 qershor të çdo viti, të vlerësimit të pjesës së energjisë së prodhuar nga BRE, krahasuar me KFBE për vitin paraardhës;
- përgatitjen e informacionit për masat që merr Ministria, përfitimeve, kostove të zhvillimit dhe përdorimit të BRE-ve, si dhe rreth masave mbështetëse, të cilat duhet të jenë transparente për të gjitha palët e interesuara.

Agjencia për Burimet e Rinovueshme edhe si rekomandim i partnerëve

Si Agjenci përgjegjëse për BRE-te³ dhe si institucion kyç në transformimin e sektorit të energjisë, ngritja e Agjencisë ka qenë pjesë e rekomandimeve të nxjerra nga raporti i vitit 2021, i organizatës ndërkombëtare Irena,³ përshtatur në shqip si më poshtë:


³ <https://www.irena.org/publications/2021/March/Reneables-Readiness-Assessment-Albania>

Megjithëse parashikohet në Ligjin për Energjinë e Rinovueshme, Shqipërisë i mungon një agjenci e dedikuar për energjinë e rinovueshme për të informuar zhvillimin e koordinuar të burimeve të rinovueshme në përputhje me detyrimet kombëtare dhe ndërkombëtare. Për më tepër, duke pasur parasysh sektorin dinamik dhe me zhvillim të shpejtë të energjisë së rinovueshme, një ent i tillë mund të ngarkohet të informojë zhvillimin e sektorit të energjisë bazuar në gjurmimin e potencialeve të burimeve, tendencave të tregut dhe praktikave më të mira globale. Objektivi i përgjithshëm duhet të synojë informimin e zhvillimit në kohë të infrastrukturës së re, burimeve njerëzore dhe legjislacionit me synimin për të përmbushur kërkesat e ardhshme për energji në një rrugë zhvillimi të qëndrueshëm dhe me kosto më të ulët për vendin.

Krijimi i një agjencie të tillë do të ishte një hap i rëndësishëm duke pasur parasysh aspiratat e vendit për të zhvilluar sektorin e energjisë për të përfshirë një pjesë më të madhe të burimeve të rinovueshme. Në fakt, duke pasur parasysh ndërlidhjet e forta ndërmjet efikasitetit të energjisë dhe burimeve të rinovueshme, dhe për të siguruar efektivitetin e kostos operacionale, një agjenci e tillë mund të shkrihet me Agjencinë ekzistuese të Efikasitetit të Energjisë.

Aktivitetet e agjencisë së energjisë së rinovueshme duhet të bazohen në mandatin e parashikuar siç përcaktohet në nenin 7 të Ligjit për Energjinë e Rinovueshme, dhe më tej të përfshijnë listën e mëposhtme jo shteruese të detyrave:

- mbajtjen e një regjistri të përditësuar të prodhuesve të energjisë së rinovueshme dhe ofruesve të shërbimeve, duke përfshirë burimet njerëzore të çertifikuara si instaluesit e certifikuar diellorë PV dhe auditorët e energjisë.
- bashkëpunimi me qendrat e trajnimit profesional dhe partnerët ndërkombëtarë për hartimin e trajnimeve, c gjurmimin e kontributeve të bilancit energjetik të të gjithë aktorëve të energjisë, duke përfshirë prodhimin e energjisë nga prodhuesit e energjisë, numrin e sistemeve të instaluar të shpërndara si PV diellore dhe termike diellore, të dhëna të ndara të konsumit të energjisë nga të gjithë sektorët ekonomikë si ekonomia familjare, transporti, industria dhe bujqësia etj.
- hartimin e vlerësimeve në kohë të peshës së burimeve të rinovueshme në sektorët e energjisë elektrike, ngrohjes dhe ftohjes dhe transportit për t'u ndarë me MIE, INSTAT dhe organizata të tjera ndërkombëtare.


- 
- monitorimi i efektivitetit dhe zbatimit në kohë të PKVRE-ve dhe masterplaneve potenciale të sektorit të energjisë
 - vlerësimin e mangësive dhe sfidave në zhvillimin e vazhdueshëm të sektorit dhe identifikimin e fushave prioritare të mbështetjes në kohën e duhur
 - studimin e tendencave të tregut të burimeve të rinovueshme, praktikat më të mira globale dhe efektivitetin e stimujve të zbatuar dhe informimin e masave të mëtejshme rregullatore dhe politikash në përputhje me rrethanat
 - kryerja e analizave të potencialit të burimeve dhe studimeve para fizibilitetit për zhvillimin e burimeve të energjisë së rinovueshme
 - ofrimin e informacionit transparent mbi të dhënat e energjisë së rinovueshme, masat nxitëse dhe mbështetëse, planet e zhvillimit të sektorit të energjisë, procedurat e lejeve dhe informacione të tjera të rëndësishme për sektorin publik dhe privat.

Për të siguruar efikasitet operacional, duhet të zhvillohet një kanal financimi për agjencinë, duke lejuar që pjesa më e madhe e kostove operacionale të mos kufizohet nga kufizimet e thesarit kombëtar ose ndarja e buxhetit të MIE. Për shembull, financimi fillestar për themelimin dhe vitet e para të funksionimit mund të mbulohet nga fondet e zhvillimit, ndërsa financimi i mëvonshëm mund të sigurohet nga kontributet e energjisë së rinovueshme në tarifatat e energjisë konsumatore, taksat mbi përdorimin e karburanteve fosile, si dhe aktivitetet e kryera brenda kompetencat e njësisë ekonomike, të tilla si matjet në terren për studimet e parafizibilitetit.

Gjetjet kryesore



Edhe pse në raportet e Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2019 dhe 2020 thuhet se projeksionet e Planit Kombëtar të Veprimit janë të kënaqshme, gjetjet e këtij raporti tregojnë se e vërteta është tjetër.



Qeveria ka punuar në drejtim të kundërt të Planit dhe Strategjisë Kombëtare për Energjinë pasi në vend të arrihej objektivit për shtimin e prodhimit të energjisë nga burime të ndryshme të rinovueshme, ka rritur kontributin e HEC-eve në prodhimin total vendas



Ngritja dhe konsolidimi i Agjencisë së Burimeve të Rinovueshme është shoqëruar me mungesë transparence sa i përket vonesës në proces. Përfshirja e kësaj agjencie si në Strategjinë Kombëtare ashtu dhe në Planin Kombëtar të veprimit, tregon qartë rëndësinë e saj si element i gjithë procesit. Nga ana tjetër, vonesa dhe mungesa e informacionit në çdo kanal zyrtar informimi të MIE, tregon qartë neglizhencën dhe mungesën e seriozitetit në lidhje me të gjithë strategjinë.

Rekomandime

Jane Ebinger, Eksperte e Energjisë pranë Bankës Botërore, sugjeron disa hapa kritikë që duhen ndjekur nga qeveria shqiptare për t'u paraprirë vështirësive edhe më të mëdha në të ardhmen:⁴



Ekzistojnë disa veprime kritike që Shqipëria mund të ndërmarrë tani për të mbështetur përdorimin optimal të energjisë, burimeve ujore dhe funksionimin e hidrocentraleve. Marrja e këtyre hapave tani do të ndihmojë Shqipërinë të menaxhojë më mirë ndryshueshmërinë e klimës dhe të ndërtojë elasticitet ndaj ndryshimeve klimatike.



Përmirësimi i mënyrës se si institucionet hidro-meteorologjike monitorojnë, parashikojnë dhe shpërndajnë informacion mbi

⁴ <https://openknowledge.eorlbank.org/handle/10986/10161>



kushtet meteorologjike dhe hidrometeorologjike. Shqipëria mund të zhvillojë brenda vendit ose të marrë nga gjetkë, parashikime të motit dhe klimës të përshtatshme për planifikimin e sektorit të energjisë. Këto do të mbulonin parashikimet me intervale të shkurtra (1-3 ditë), parashikimet me intervale të mesme (3-10 ditë), parashikimet sezonale dhe parashikimet rajonale të ndryshimeve klimatike të zvogëluara. Informacioni mund të ndihmojë palët e interesuara të sektorit të energjisë të ndërmarrin vlerësime të përbashkëta të rrezikut klimatik mbi burimet e përbashkëta ujore dhe rrjetet rajonale të energjisë, dhe të hartojnë strategji të dakorduara për të menaxhuar dobësitë dhe rreziqet e identifikuar klimatike.



Përmirësimi i efikasitetit të energjisë duke reduktuar humbjet e sistemit dhe duke inkurajuar e ndihmuar përdoruesit përfundimtarë të menaxhojnë kërkesën e tyre për energji.



Përmirësimi i planeve të emergjencës (ECP) për hidrocentralet aty ku nevojitet, për të llogaritur rritjen e pritshme të intensitetit të reshjeve për shkak të ndryshimeve klimatike. Prodhuesit e energjisë dhe autoritetet lokale mund të kenë nevojë gjithashtu të përmirësojnë kapacitetin e tyre për të zbatuar ECP-të, duke siguruar që ato ofrojnë mekanizma të shëndoshë për monitorimin e motit dhe ndikimin e tij në rrjedhat e lumenjve dhe nivelet e rezervuarëve. Ata gjithashtu do të duhet të përmirësojnë komunikimin e tyre me komunitetet e poshtme dhe planet e emergjencës për evakuim.



Sigurimi i administrimit dhe zhvillimit të burimeve ujore është i integruar në të gjithë sektorët -- energjinë, bujqësinë, furnizimin me ujë dhe kanalizimet -- dhe merr parasysh shqetësimet ndërkufitare, së bashku me shqetësimet mjedisore dhe sociale.



Eksplorimi i mundësive të mëtejshme të përshtatjes. Ndryshimet klimatike e bëjnë të domosdoshme që Shqipëria të diversifikojë furnizimet e saj me energji përmes rritjes së tregtisë rajonale të energjisë dhe portofolit më të larmishëm të aseteve të prodhimit vendas. Me marrjen në konsideratë të vendit për investime të mëdha në përmirësimin e aseteve të reja energjetike dhe privatizimin e aseteve, sa më të hershme të merren parasysh rreziqet klimatike, aq më të mëdha janë mundësitë për të identifikuar dhe zbatuar zgjidhje që e bëjnë sistemin energjetik më të fuqishëm dhe elastik për dekadat e ardhshme.

#QËNDRESË/MIRËQEVERISJE

Ky raport publikohet në kuadër të nismës së Qëndresës Qytetare për të nxitur transparencën dhe përgjegjshmërinë e qeverisë me mbështetjen e National Endowment for Democracy (NED)

Analistët e rinj të politikave publike të angazhuar në këtë nismë do të prodhojnë raporte monitoruese periodike në fushat kryesore të qeverisjes dhe do të angazhohen në përpjekje për avokim me zyrtarë të shtetit, ligjvënësit, ekspertë dhe shoqërinë civile për të promovuar rekomandime që do të rrisin transparencën dhe përgjegjshmërinë e zyrtarëve dhe qeverisë. Mendimet dhe opinionet e shprehura në këtë raport i përkasin autorit realizues dhe nuk përkojnë domosdoshmërisht me qëndrimet e National Endowment for Democracy (NED) dhe Qëndresës Qytetare.

